



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr 23/ Prot

Tiranë, më 31.01.2020

PROCESVERBAL

Sot, më datën 31.01.2020 ditë e premte, ora 12.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, u mbajt mbledhja plenare e radhës e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri në 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli mbledhet në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Gent Ibrahimimi
2. Alfred Balla
3. Nurihan Seiti
4. Tartar Bazaj
5. Arben Dollapaj
6. Bujar Sheshi
7. Kosta Beluri
8. Vate Staka
9. Sander Beci
10. Besnik Cani

Nuk janë të pranishëm anëtarët:

1. Esmeralda Keshi.

Gjithashtu, janë të ftuar të jenë të pranishëm përfaqësues nga projektet OPDAT dhe EURALIUS, Ministria e Drejtësisë si dhe vezhgues nga organizata të tjera.

Nga administrata e KLP janë të pranishëm:

1. Drejtori i Kabinetit

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë z.Gent Ibrahimimi, i cili në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të



Drejtësisë” i ndryshuar, pasi konstaton vlefshmërinë e mbledhjes, bën hapjen e saj dhe kalon në prezantimin e rendit të ditës:

Rendi i Ditës:

1. Miratimi i projektaktit “Për emërimin e prokurores Doreza Musabelliu në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
2. Miratimi i projektaktit për miratimin e raportit për verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore të kandidatit Armida Kaçi për t’u pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020.
3. Miratimi i projektaktit për miratimin e raportit për verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore të kandidatit Griselda Haxhijaj për t’u pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020.
4. Miratimi i projektaktit për miratimin e raportit për verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore të kandidatit Leonard Suçi për t’u pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020.
5. Miratimi i projektaktit “Për miratimin e listës pjesore të kandidatëve të pranuar në formimin fillestar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020.
6. Të tjera (pyetje, përgjigje, diskutime).

Më pas Kryetari parashtroi propozimin e paraqitur me shkrim nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për përfshirjen në rendin e ditës të çështjeve shtesë si më poshtë:

Z. Ibrahim paraqet propozimin me shkrim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për:

1. Komandimin e një magjistrati pranë ILD.

Z. Ibrahim pyet nëse anëtarët kanë çështje të tjera për të përfshirë në rend të ditës.

2. **Z. Beci** paraqet kërkesën për dorëheqjen e z. Agim Dilka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Elbasan dhe miratimin e saj.

Z. Ibrahim hedh në votim propozimin për përfshirjen në rendin e ditës të çështjeve më lart.

Miratohen me 10 vota pro.

Z. Ibrahim vijon me pikën e parë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektaktit “Për emërimin e prokurores Doreza Musabelliu në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”.*



Z. Ibrahim i relatohet çështjen dhe i kërkon Këshillit që ta firmosë vendimin sapo të miratohet emërimi i znj. Musabelliut, me qëllim betimin e saj në Presidencë (po në këtë ditë).

Z. Ibrahim i pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Anëtarët paraqitën komentet si vijon:

Znj. Seti propozon që, këtij emërimi ti shtohet njoftimi për vendimin e Komisionerit Publik për mosankim.

Z. Ibrahim i sqaron se, kërkohet që në bazën ligjore të draft vendimit të përfshihej dhe vendimi i Komisionerit i cili ka shpallur mosankimi ndaj vendimit të shkallës së parë. Sqaron se vendimi i Komisionerit është bërë publik. Bën me dije se, Këshilli dhe në vendimet e mara për 8 prokurorët e mëparshëm nuk i është referuar vendimit të Komisionerit për mosankimin pasi është kusht i domosdoshëm për emërimin në SPAK. Propozon që dhe vendimi i sotëm të jetë në formatin e mëparshëm. Lexon vendimin e Këshillit bazuar në: nenin 148/dh të Kushtetutës, nenin 48/1, 163/2 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve” në Republikën e Shqipërisë, nenin 4, 12 të ligjit 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e insitucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, KLP pasi ka verifikuar të gjitha kriteret në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur dhe referuar vendimit të Këshillit për miratimin e listës për prokuror në Prokurorinë e Posaçme, vendosi emërimin e znj. Musabelliut, vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Z. Ibrahim i hedh në votim miratimin e projektvendimit.

Miratohet me 10 vota pro.

Z. Ibrahim i vijon me pikën e dytë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektaktit për miratimin e raportit për verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore të kandidatit Armida Kaçi për t’u pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020.*

Z. Ibrahim i rifillon mbledhjen plenare pas ndërprerjes që Këshilli bëri për të firmosur vendimin e emërimit të znj. Musabelliut. Konfirmon praninë në sallë të znj. Esmeralda Keshi.

I kalon fjalën z. Beluri, si relator në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale. Bazuar në nenin 32 të ligjit nr. 96/2016“ Për statusin e gjyqtarëve

dhe prokurorëve” i ndryshuar, komisioni pas përfundimit të raportit të kontrollit të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatës të pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, i propozon Këshillit të konsiderojë të përfunduar dhe të pranueshëm këtë raport. Bazuar në nenin 189 pika 1, gërma a, të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” neni 32, të ligjit 96/2016“ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, Këshilli pasi u njoh me raportin e komisionit të referuar nga Z. Beluri, vendosi miratimin e raportit për znj. Kaçi. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Z. Ibrahim i pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Z. Bazaj është dakord me konkluzionet e Komisionit.

Z. Dollapaj është dakord me konkluzionet e Komisionit. Propozon që Këshilli duhet të azhurnohet me praktikën e KPA, sepse në vendimet e tyre janë vendosur disa standarte që kanë të bëjnë me procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës së magjistratëve. Këto të harmonizuara drejt dhe me ligjin për deklarimin e pasurisë së magjistratëve dhe kandidatëve, ka një element që lidhet me përkufizimin: kush janë personat e lidhur me magjistratin. Të vendoset një standart për këtë praktikë. Mbështet qëndrimin që ka mbajtur ILDKP lidhur me interpretimin që: prindërit nuk cilësohen si persona të lidhur. Citon dhe një Vendim të KPA lidhur me këtë çështje, ku përcakton që pjesë e verifikimit për personat e lidhur është vetëm pjesa që ka hyrë në marrëdhënie me magjistratin, (huadhënie dhe huamarje). Duke parë të gjithë dokumentacionin që ka paraqitur kandidata për magjistrate, ajo pjesë që konsiderohet hua, dhuratë, është plotësisht e justifikuar.

Znj. Seiti vlerëson që Këshilli nuk ka pasur një rast të tillë që një magjistrat të ketë një konfigurim të tillë, siç është pasuria. Standardet duhet të qëndrojnë, por vlerëson që elementi kryesor është e drejta për edukim (sipas kushtetutës). ILDKP bën interpretimin e vet, por thekson që ata anë kandidatë për magjistratë që nuk kanë dhënë asnjë vendim, pra nuk janë magjistratë.

Z. Balla bën me dije një praktikë gjyqësore shqiptare të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, e cila shfuqizoi një vendim të KLGJ që e skualifikoi kandidatin, me arsyetimin se këta kandidatë janë studentë dhe në raportet e tyre kanë deklaruar vetëm pasurinë e tyre, nuk kanë futur personat e lidhur. Raporti i ILDKPI nuk është vendimtar, kjo e drejtë i takon Këshillit.

Z. Beluri sqaron se për rastin konkret, Komisioni nuk mund të referohet ligjit për rivlerësimin kalimtar dhe gjyqtarëve dhe prokurorëve. Vështirësia në përpilimin e raportit, për këto subjekte ishte se Komisioni duhej të referohej pikës 4 neni 32 i ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, pavarësisht se Komisioni ka



mbajtur parasysh qëndrimin e KPK dhe KPA dhe vendimin e Gjykatës Administrative. Thekson që këto subjekte, nuk janë subjekte të ligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projektvendimit.

Miratohet me 10 vota pro.

Z. Ibrahim vijon me pikën e tretë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektaktit për miratimin e raportit për verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore të kandidatit Griselda Haxhiaj për t'u pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020.*

Z. Ibrahim njofton Këshillin për largimin nga salla, për shkak të pjesëmarrjes së tij në ceremoninë e betimit të znj. Musabelliu në Presidencë dhe ia kalon drejtimin e mbledhjes plenare z. Balla.

Meqënëse në raportet që do të relatohen në vazhdim, ka të dhëna konfidenciale si dhe informacione sensitive, u kërkon anëtarëve dhe pjesëmarrësve të largohen nga salla, derisa Këshilli të dalë në një qëndrim.

Z. Ibrahim bëri me dije qëndrimin e Këshillit: Vetëm ata anëtarë të Këshillit që disponojnë një çertifikatë të vlefshme sigure në momentin që diskutohen raportet e mëposhtme, mund të kenë akses te dokumentat bazë sekrete që i janë vënë në dispozicion Këshillit. Anëtarët e tjerë do të marrin pjesë në diskutim dhe do të marrin të mirëqëna komentet e kolegëve që kanë çertifikata. Këshilli në këtë mënyrë, mundëson vendimmarrjen dhe nuk cënon as rregullat për ruajtjen e sekretit shtetëror.

Vijon mbledhja e Këshillit nën drejtimin e Z. Balla.

Z. Balla merr fjalën si relator në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale. Bazuar në nenin 32 të ligjit 96/2016“ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i ndryshuar, komisioni pas përfundimit të raportit të kontrollit të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit të pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, i propozon Këshillit ta konsiderojë të përfunduar dhe të pranueshëm këtë raport. Bazuar në nenin 189 pika 1, gërma a, të ligjit “ Për organet e qeverisjes së neni 32, të të ligjit 96/2016“ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, Këshilli pasi u njoh me raportin e komisionit, vendosi miratimin e raportit për znj. {...}. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.



Bën me dije se, mbledhja plenare do të zhvillohet me dyer të mbyllura vetëm me praninë e anëtarëve Këshillit (neni 32 i ligjit (“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”).

Z. Balla pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Z. Balla hedh në votim miratimin e projektvendimit.

Miratohet me 10 vota pro, në mungesë z. Ibrahim.

Z. Balla vijon me pikën e katërt të rendit të ditës.

- *Miratimi i projektaktit për miratimin e raportit për verifikimin e pasurisë, figurës dhe integritetit si dhe kushteve të tjera ligjore të kandidatit Leonard Suçi për t’u pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020.*

I kalon fjalën znj. Keshi si relator në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale. Bazuar në nenin 32 të ligjit 96/2016“ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i ndryshuar, komisioni pas përfundimit të raportit të kontrollit të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit të pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, i propozon Këshillit ta konsiderojë të përfunduar dhe të pranueshëm këtë raport. Bazuar në nenin 189 pika 1, gërma a, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” neni 32, të ligjit 96/2016“ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, Këshilli pasi u njoh me raportin e komisionit, vendosi miratimin e raportit për z. Suçi. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Bën me dije se, mbledhja plenare do të zhvillohet me dyer të mbyllura vetëm me praninë e anëtarëve Këshillit, për shkak të informacioneve sensitive që përmban raporti (neni 32 i ligjit 96/2016 i ligjit (“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”).

Z. Balla pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Z. Balla hedh në votim miratimin e projektvendimit.

Miratohet me 10 vota pro, në mungesë z. Ibrahim.

Z. Balla i kërkon përgjegjësit të sektorit të dokumentimit të seancave, z. Sulisufi të marrë masat të rinjoftohen që të jenë të pranishëm pjesëmarrësit e tjerë.

Z. Balla vijon me pikën e pestë të rendit të ditës.



Miratimin e projektaktit “Për miratimin e listës pjesore të tre kandidatëve të pranuar në formimin fillestar Shkollën e Magistraturës në vitin akademik 2019-2020”.

Miratimi i kësaj listë bëhet në përputhje me nenin 32, pika 7 të ligjit ligjit 96/2016“ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” në Republikën e Shqipërisë.

Z. Balla pyet nëse ka pyetje dhe komente. Pyetje nuk ka.

Z. Balla hedh në votim miratimin e projektvendimit.

Miratohet me 10 vota pro, në mungesë z. Ibrahim.

Z.Balla vijon me pikën që u shtua në rend të ditës.

Trajtimin e kërkesës së ILD për komandimin e një magjistrati pranë ILD në baze të neni 54 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” në funksion të përmbushjes së detyrave kushtetuese të zyrës së ILD, emergjencë e burimeve njëzore i kërkon KLP, të vlerësojë nisjen e procedurave për shpalljen e pozicionit për komandimin e një magjistrati pranë ILD për një periudhë 5 vjeçare. Citon projekaktin për shpalljen e procedurave të komandimit të një magjistrati pranë ILD.

Z. Balla pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Z. Balla hedh në votim miratimin e projektvendimit.

Miratohet me 10 vota pro, në mungesë të z. Ibrahim.

Z.Balla vijon me pikën e fundit të rendit të ditës.

➤ Pranimin e dorëheqjes së paraqitur nga prokurori Agim Dilka.

I kalon fjalën z. Beluri si relator në emër të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, lidhur me kërkesën për heqje dorë nga funksioni. Në KLP është regjistruar kërkesa e prokurorit bazuar neni 64 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar. Dorëheqjen e arsyeton në faktin se prej dt 19.12.2019 ka mbushur moshën 65 vjeç dhe gjëndja e tij shëndetësore e bën të pamundur ushtrimin e funksionit (në interpretim të pikës 2 të nenit 65 të ligjit 96/2016 “ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”), i ndryshuar. Bazuar në nenin 64 dhe nenin 65 të ligjit të sipërpërmendur, neni 89, pika 1, gërma a të ligjit nr. 115/2016 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, KLP duhet të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të



dorëheqjes. Komisioni, i propozon Këshillit të deklarojë me vendim mbarimin e statusit të këtij magjistrati, efektet e të cilit përfundojnë në datën 29.02.2020.

Këshilli duhet të njoftojë dhe Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për vendimmarrjen.

(Relacioni i plotë është pjesë e dokumentacionit të dosjes plenare si dhe mund të dëgjohet në regjistrimin audio të seancës të dokumentuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Z. Balla pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Z. Balla hedh në votim miratimin e projektvendimit për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit Dilka për shkak të dorëheqjes.

Miratohet me 10 vota pro, në mungesë të z. Ibrahim.

Në përfundim, Këshilli në mbledhjen e sotme plenare miratoi Vendimet për gjashtë pikat e rendit të ditës si dhe vendimet për dy pikat të cilat u shtuan në rendin e ditës.

- Fillimin e procedurave të komandimit të një magjistrati pranë ILD.
- Pranimin e dorëheqjes nga prokurori Agim Dilka.

Në përfundim duke mos patur pika të tjera për diskutim Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

(Sonila Çeliku)

KRYETARI

Gent Ibrahimi





Shënim:

(Shënimi i mëposhtëm vendoset pas përfundimit të të gjithë procedurave të rishikimit)

Lidhur me këtë procesverbal janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësi nga anëtarët e KLP-së.
Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. ___ Datë ___ 2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. ___ datë ___ (Bashkëngjitur kopjet e dokumenteve)
Procesverbali i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së datë 11/02/2020
Procesverbali të arkivohet

PËRGJEGJËSI SEKTORIT SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Frederik Sulisufi